

20212844489

Në bazë të nenit 47, paragrafit (1), nënparagrafit 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/21), ndërsa në lidhje me nenin 72, paragrafi 3 i Ligjit të Letrave me Vlerë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 95/05, 25/07, 7/08, 57/10, 135/11, 13/13, 188/13, 43/14, 15/15, 154/15, 192/15, 23/16 dhe 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 31/20), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

RREGULLAT E MËNYRËS DHE PROCEDURËS SË TREGTIMIT DHE SHESHIMIT SË TRANSAKSIONEVE TË LETRAVE ME VLERË TË TREGJEVE NËPËRMJET SPORTEELIT

I. Dispozitat themelore

Neni 1

Me këto rregulla përcaktohen mënyra dhe procedura e tregtimit dhe sheshimit së transaksioneve të letrave me vlerë të tregjeve nëpërmjet sportelit.

Neni 2

Shkurtesat e përdorura në këto rregulla kanë kuptimin vijues:

BPRMV:	është Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
SNPM:	është Sistemi Ndërbankar i Pagesave të Maqedonisë
TARGET 2:	është sistemi i pagesave të Sistemit European të Bankave Qendrore
DQLV:	është Depozitari Qendror i Letrave me Vlerë.

Termet e përdorura në këto rregulla kanë kuptimin vijues:

Tregjet përmes sportelit: janë pazaret e organizuara nga BPRMV, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, ku bëhet blerja dhe shitja e letrave me vlerë dhe obligacioneve shtetërore (përveç obligacioneve të lëshuara për pagesën e devizave të depozituara të qytetarëve dhe obligacioneve të shkombëtarizimit) dhe realizmi i kontratave repo.

Transaksioni përfundimtar: është shitblerja e letrave me vlerë, pa detyrim të rishitjes, përkatësisht blerjes.

Transaksioni repo: është shitja/blerja e letrave me vlerë me detyrim të riblerjes/rishitjes së tyre ose e letrave me vlerë të barasvlershme.

- Çmim i pastër: është çmimi i rënë dakord ndërmjet blerësit dhe shitësit gjatë lidhjes së transaksioneve me letrat me vlerë të kuponit, e cila nuk përmban interesin e akumuluar nga fillimi i periudhës së kuponit, në të cilën bëhet tregtimi deri në datën e sheshimit të transaksionit.
- Çmimi bruto: është çmimi që përmban çmimin e pastër dhe interesin e akumuluar të fillimit të periudhës së kuponit, në të cilën bëhet tregtimi deri në datën e sheshimit të transaksionit.
- Sistemi i kryqëzimit: është sistem elektronik i BPRMV-së për kryqëzimin e porosive të bartjes së pronësisë në letra me vlerë të denarit.
- Llogaria e veçantë e sheshimit: është llogaria e pjesëmarrësit në SNPM që shërben si sheshim i transaksioneve me letra me vlerë të lidhura në tregje nëpërmjet sportelit.
- Llogaria e DQLV në SNP: është llogaria në të cilën DQLV transferon përkohësisht mjetet financiare të llogarisë së bankës blerëse/blerësit, për shkak të transferimit të tyre përfundimtar në llogarinë e bankës blerëse/blerësit.
- ISIN - International Securities Identification Number): është kodi ndërkombëtar i identifikimit të letrave me vlerë, të lëshuara në tregjet financiare.
- Dorëzimi kundrejt pagesës Versus Delivery Payment-DVP): është parimi i sheshimit që siguron transferimin përfundimtar të letrave me vlerë me transferim të njëkohshëm të mjeteve financiare.
- Dorëzimi pa pagesë (Free of Payment – FOP): është parimi i sheshimit që siguron transferimin përfundimtar të pronësisë së letrave me vlerë pa transferim të mjeteve financiare.
- Ditë pune është:
- a) Në lidhje me transferimin e mjeteve financiare në denarë, dita në të cilën SNPM-ja është e hapur për punë;
 - (b) Në lidhje me transferimin e mjeteve financiare në euro, dita në të cilën TARGET2 është i hapur për punë;
 - c) Në lidhje me transferimin e pronësisë së letrave me vlerë, dita në të cilën depozituesit ku është e regjistruar pronësia e letrave me vlerë janë të hapur për punë.

II. Tregtimi i letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit

Neni 3

Me tregtimin e letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit nënkuptohet shitblerja e letrave me vlerë, të rënë dakord midis blerësit dhe shitësit jashtë Bursës.

Neni 4

Blerës, përkatësisht shitës i letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit është çdo person juridik dhe fizik.

Neni 5

Tregtimi i letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit bëhet vetëm me letrat me vlerë të regjistruara.

Në ditën e punës përpara ditës së dorëzimit të shumës nominale të letrave me vlerë, nuk bëhet tregtimi i letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit.

Neni 6

Në tregjet nëpërmjet sportelit, blerësi dhe shitësi bien dakord për shitblerje të letrave me vlerë me kontakt të drejtpërdrejtë, nëpërmjet telefonit, komunikimit elektronik ose ndonjë mjeti tjetër të komunikimit.

Gjatë marrëveshjes së drejtpërdrejtë, blerësi dhe shitësi lidhin kontratën e shitblerjes.

Gjatë marrëveshjes telefonike, komunikimit elektronik ose mjeteve të tjera të komunikimit, blerësi dhe shitësi shkëmbejnë vërtetimin, përkatësisht lidhin përfundimin, i cili ka fuqi juridike në kontratën e shitblerjes.

Neni 7

Elementet thelbësore të transaksionit të shitblerjes së letrave me vlerë, të cilat janë dakorduar detyrimisht nga blerësi dhe shitësi janë:

- lloji i transaksionit (definitiv ose trasaksion repo);
- ISIN-i i letrave me vlerë
- shuma nominale;
- çmimi;
- data e lidhjes;
- data dhe koha e sheshimit;
- llogaritë e letrave me vlerë në DQLV;
- llogaritë bankare.

Gjatë lidhjes së transaksioneve definitive me letrat me vlerë të kuponit, blerësi dhe shitësi dakordohen për çmimin e pastër dhe llogaritin çmimin bruto.

Gjatë lidhjes së transaksioneve repo, blerësi dhe shitësi dakordohen për elementet thelbësore në pajtim me “Kontratën repo të përgjithshme”.

Neni 8

Kur blerësi dhe shitësi për herë të parë kontaktojnë për shitblerjen e letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit, shkëmbejnë të dhënat e nevojshme për identifikimin e ndërsjellë (personat e kontaktit, numrin e telefonit, faksin, adresën etj.).

Për të gjitha ndryshimet e paragrafit (1) të këtij neni, blerësi dhe shitësi njoftohen me njëri-tjetrin.

Neni 9

Bankat që disponojnë me sistemin informativ TBP (Tenfore Banking Package), kuotojnë çmimet e blerjes dhe shitjes së letrave shtetërore me vlerë, çdo ditë pune nga ora 9:00 deri në orën 16:00.

Bankat i vendosin çmimet e kuotuarat të blerjes dhe shitjes (për letrat me vlerë që i posedojnë) për çdo maturim, minimal për letrat shtetërore me vlerë nga emetimi i fundit.

Çmimet e kuotuar zbatohen për transaksionet deri në 1.000.000,00 denarë. Nëse shuma e transaksionit është më e madhe se 1.000.000,00 denarë, palët kontraktuese dakordohen për çmimin me të cilin do të lidhet transaksioni. Çmimet e kuotuar të letrave shtetërore me vlerë publikohen në faqen e internetit të BPRMV-së.

III. Sheshimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit

Neni 10

Sheshimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit bëhet sipas parimit “dorëzimi kundrejt pagesës”.

Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, gjatë blerjes së përkohshme të letrave me vlerë nga BPRMV-ja për t’u siguruar bankave likuiditet në euro, në bazë të linjës së kredisë (repo) në euro të miratuar të BPRMV-së nga Banka Qendrore Europiane, si dhe gjatë menaxhimit të ekspozimit të transaksionet repo, zbatohet parimi i “dorëzimit pa pagesë”.

Gjatë sheshimit të transaksioneve me instrumentet e sigurimit që janë të lëshuara në tregjet financiare ndërkombëtare, BPRMV-ja i miraton mjetet financiare pas marrjes së vërtetimit për transferimin përfundimtar të pronësisë së letrave me vlerë në llogarinë e BPRMV-së.

Neni 11

Pjesëmarrës në sheshimin e transaksioneve të letrave me vlerë janë bankat dhe BPRMV-ja, në rolin e bankës blerëse, përkatësisht banka shitëse, të cilat dorëzojnë udhëzime për sheshimin e transaksioneve të letrave me vlerë në emër të tyre dhe për llogarinë e tyre.

Në rast kur blerësi, përkatësisht shitësi nuk është bankë, elementet thelbësore të theksuara në nenin 7 të këtyre rregullave i dorëzon në formularin e përcaktuar në bankë, i cili është i detyruar të identifikojë pronarin e llogarisë së letrave me vlerë në DQLV. Banka paraqitet në rolin e bankës së blerësit, përkatësisht bankës së shitësit dhe dorëzon udhëzime për sheshimin e transaksioneve të letrave me vlerë në emër të saj, por në llogari të dikujt tjetër.

Në transaksionet repo, blerësi i “Kontratës repo të përgjithshme” i dorëzon elementet thelbësore, përkatësisht udhëzimet e sheshimit, në datën e blerjes si shitës i letrave me vlerë, ndërsa në datën e riblerjes si blerës i letrave me vlerë. Shitësi i “Kontratës repo të përgjithshme” i dorëzon elementet thelbësore, përkatësisht udhëzimet e sheshimit, në datën e blerjes si shitës i letrave me vlerë, ndërsa në datën e riblerjes si blerës i letrave me vlerë.

Neni 12

Sistemet nëpërmjet të cilave bëhet sheshimi i transaksioneve të letrave me vlerë janë:

- SNPM – siguron rrjedhën e pandërprerë të porosive për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë dhe mundëson transferimin e mjeteve financiare;
- Sistemi i kryqëzimit – siguron kryqëzimin e porosive të zbatuara nëpërmjet SNPM-së për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë;
- TARGET2 – mundëson transferimin e mjeteve financiare në rast kur miratohet likuiditeti devizor në euro;
- Sistemi i DQLV-së – bën transferimin e pronësisë së letrave me vlerë.

Neni 13

Sheshimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit bëhet vetëm me letrat me vlerë të regjistruara.

Në ditën e punës para ditës së dorëzimit të shumës nominale të letrave me vlerë, nuk bëhet sheshimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit.

Neni 14

Sheshimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit mund të bëhet menjëherë, por jo më vonë se dy ditë pune nga dita e lidhjes së transaksionit.

Në transaksionet repo, paragrafi (1) i këtij neni, i referohet vetëm sheshimit të datës së blerjes në pajtim me “Kontratën repo të përgjithshme”.

Neni 15

Pjesëmarrësit i dorëzojnë udhëzimet e sheshimit në llojin e porosive standarde elektronike të përcaktuara për transferimin e pronësisë, përfshirë për transferimin e mjeteve financiare, në pajtim me “Standardin e qëllimit dhe formatin e porosive në Sistemin e kryqëzimit” dhe “Standardin e qëllimit dhe formatin e porosive në SNPM”.

Pjesëmarrësit i dorëzojnë porositë e paragrafit (1) të këtij neni te SNPM-ja dhe te Sistemi i kryqëzimit në ditën e sheshimit, në pajtim me afatin e planit të punës së SNPM-së.

Neni 16

Për transferimin e mjeteve financiare në lidhje me sheshimin e transaksioneve të letrave me vlerë, pjesëmarrësit hapin llogari të veçantë të sheshimit në SNPM.

Për transferimin e pronësisë në lidhje me sheshimin e transaksioneve të letrave me vlerë, pjesëmarrësit duhet të jenë të regjistruar në DQLV, në pajtim me rregullat e tij.

Neni 17

Llogaritë e veçanta në SNPM, mund t'i detyrojnë vetëm DQLV-ja dhe BPRMV-ja.

Nëse pas skadimit të kohës për pranimin e porosive për transferimin e mjeteve në denarë ka mjete në llogarinë e veçantë, BPRMV-ja automatikisht i kthen ato në llogarinë e rregullt të pjesëmarrësit në SNPM.

DQLV-ja dhe BPRMV-ja kryejnë detyrimin e llogarisë së veçantë të pjesëmarrësit, në pajtim me Autorizimin e detyrimit të llogarisë së dhënë nga pjesëmarrësi i shtojcës 1 të “Rregullave të punës në Sistemin Ndërbankar të Pagesës në Maqedoni”.

Dërgimi i porosive për transferimin e mjeteve financiare dhe pronësisë së letrave me vlerë

Neni 18

Në ditën e sheshimit, pjesëmarrësit dërgojnë porosi të plotësuara saktë te SNPM-ja dhe te Sistemi i Kryqëzimit sipas paraqitjes skematike (shtojca 1), si dhe në pajtim me “Standardin e qëllimit dhe formatit të porosive në Sistemin e kryqëzimit dhe “Standardin e qëllimit dhe formatit të porosive në SNPM”.

Gjatë blerjes së letrave me vlerë, banka blerëse/e blerësit dërgon porosi për transferimin e mjeteve financiare nga llogaria e rregullt e llogarisë së veçantë të sheshimit në SNPM-në, hapi (1) dhe porosia për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë te Sistemi i Kryqëzimit, hapi (2a). Gjatë shitjes së letrave me vlerë, banka shitëse/ e shitësit dërgon porosi për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë te Sistemi i Kryqëzimit, hapi (2b).

Gjatë transferimit të pronësisë së letrave me vlerë pa transferimin e mjeteve financiare, banka blerëse/e blerësit dhe banka shitëse/ e shitësit i dërgojnë vetëm porosi të transferimit të pronësisë së letrave me vlerë.

Neni 19

Pjesëmarrësit mund t'i anulojnë porositë për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë para se të ndodh kryqëzimi dhe dërgimi i tyre në DQLV.

Pjesëmarrësit mund të kërkojnë rimbursim të mjeteve financiare nga llogaria e veçantë e llogarisë së rregullt të sheshimit në SNPM, para se të ndodh kryqëzimi i porosive për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë dhe dërgimi i tyre në DQLV.

Porositë e kryqëzuara për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë

Neni 20

Sistemi i kryqëzimit kryen kontrollin e elementeve të porosive për transferimin e pronësisë së hapave (2a) dhe (2b) dhe raporton gabimet.

Pas kontrollit të kryer, Sistemi i kryqëzimit, krahason elementet e porosive për transferimin e pronësisë së hapave (2a) dhe (2b), si dhe nëse vjen deri te kryqëzimi i porosive, dërgon porosinë e vetme për transferimin e pronësisë te DQLV-ja, hapi (3).

Kontrolli dhe krahasimi i elementeve të porosive për transferimin e pronësisë së hapave (2a) dhe (2b) bëhet në pajtim me “Standardin e qëllimit dhe formatit të porosive në Sistemin e kryqëzimit”.

Neni 21

Nëse nuk vjen deri te kryqëzimi i porosive për transferimin e pronësisë së hapave (2a) dhe (2b) në skadimin e periudhës së përcaktuar në paragrafin (2) të nenit 15 të këtyre rregullave, porositë për transferimin e pronësisë do të konsiderohen të pavlefshme.

Në rast të gabimeve të ndodhura në paragrafin (1) të nenit 20 dhe porosive të pavlefshme të paragrafit (1) të këtij neni, sheshimi i transaksionit nuk bëhet dhe nuk ka pasoja për BPRMV-në.

Sheshimi

Neni 22

Pas marrjes së porosisë së vetme për transferimin e pronësisë së Sisemit të kryqëzimit, DQLV-ja përcakton gjendjen e llogarisë së letrave me vlerë të shitësit.

Gjatë sheshimit të transaksioneve definitive të letrave me vlerë të kuponit, DQLV-ja bën përlllogaritjen e interesit të akumuluar nga fillimi i periudhës së kuponit, në të cilën bëhet tregtimi, deri në datën e sheshimit të transaksionit.

Pas përcaktimit të kryer, në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, DQLV-ja e kontrollon llogarinë e veçantë të bankës blerëse/blerësit në SNPM, në të cilën janë transferuar mjetet financiare të blerjes së letrave me vlerë. Nëse në llogarinë e vepantë të llogarisë së bankës blerëse/blerësit në SNPM ka mjaftueshëm mjete financiare të sheshimit, DQLV-ja bën transferimin e mjeteve financiare të llogarisë së veçantë të bankës blerëse/blerësit në SNPM të llogarisë së DQLV-së në SNPM, hapi (4).

DQLV-ja i transferon mjetet financiare nga llogaria e DQLV-së në SNPM, në llogarinë e rregullt të bankës shitëse/shitësit, hapi (5).

Në të njëjtën kohë, me transferimin e mjeteve financiare, DQLV-ja bën transferimin e pronësisë së letrave me vlerë nga llogaria e shitësit në llogarinë e blerësit.

Me përjashtim të paragrafëve (3), (4) dhe (5) të këtij neni, DQLV-ja bën transferimin e pronësisë së letrave me vlerë pa transferim të mjeteve financiare, në bazë të porosive të dorëzuara në pajtim me “Standardin e qëllimit dhe formatit të porosive në Sistemin e kryqëzimit”. Gjatë transferimit të pronësisë në bazë të zëvendësimit të letrave me vlerë, nga ana e blerësit dhe shitësit dorëzohen udhëzimet e zëvendësimit te DQLV-ja, në formular të përcaktuar në pajtim me shtojcën 2 të këtyre rregullave.

Neni 23

Nëse kushtet e sheshimit të transaksionit të paragrafëve (1) dhe (3) të nenit 22 nuk plotësohen, sheshimi nuk bëhet dhe nuk ka pasoja të DQLV-së.

Neni 24

DQLV-ja e njofton BPRMV-në për rezultatin (të dalurën) e sheshimit, hapi (6).

BPRMV-ja e dorëzon raportin e DQLV-së te pjesëmarrësit nëpërmjet Sistemit të kryqëzimit, pa i kontrolluar përmbajtjen dhe formatin e saj, hapi (7).

Neni 25

Pjesëmarrësit janë të detyruar të kryejnë kontrollin e raportit dhe udhëzimet e sheshimit në afat prej dy orësh nga pranimi i raportit të nenit 24 dhe në rast gabimi tek elementet e porositve për transferimin e pronësisë së letrave me vlerë, të njoftojnë BPRMV-në me dorëzim të dokumentacionit përkatës të transaksionit konkret.

Në bazë të dokumentacionit të fituar, BPRMV-ja i njofton pjesëmarrësit dhe DQLV-në për mënyrën e korrigjimit të gabimit. Korrigjimi i gabimit bëhet në të njëjtën ditë pune, nëse dokumentacioni i transaksionit konkret është dorëzuar te BPRMV-ja, më së voni në ora 15:00, përkatësisht ditën vijuese të punës, nëse dokumentacioni i transaksionit konkret është dorëzuar te BPRMV-ja pas orës 15:00.

Neni 26

Ndërprerja e procesit të sheshimit të transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit të BPRMV-ja dhe DQLV-ja mund të ndodhë për shkak të:

- ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike;
- mosfunksionimit të pajisjeve dhe serverëve të komunikimit;
- veprimit të forcës madhore (vis major).

Gjatë rreziqeve të theksuara, ndërpritet përkohësisht procesi i sheshimit të transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit. BPRMV-ja dhe/ose DQLV-ja do t'i njoftojnë bankat në mënyrë plotësuese për datën dhe kohën e vazhdimit të procesit të sheshimit të transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit.

IV. Njoftimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit

Neni 27

Bankat e njoftojnë BPRMV-në për transaksionet kontraktuese të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit, sipas mënyrës elektronike.

Bankat në kohën reale dorëzojnë njoftimet te BPRMV-ja për transaksionet definitive të lidhura me personat juridik, ndërsa në fund të ditës, për transaksionet definitive me personat fizik dhe transaksionet repo. Njoftimet e transaksioneve repo të lidhura midis bankave i dorëzon banka shitëse e letrave me vlerë. Në rast kur banka nuk është pala kontraktuese te transaksioni definitiv ose ai repo, në fund të ditës, njoftimet e transaksioneve të lidhura i borëzon banka e shitësit të letrave me vlerë.

Bankat dorëzojnë raportet e transaksioneve të lidhura të paragrafit (2) të këtij neni, të përcaktuara në formularët e shtojcës 2 të këtyre rregullave.

Bankat mbajnë evidencë elektronike të transaksioneve të lidhura me personat fizik në formularët e përcaktuar.

Neni 28

BPRMV-ja përpilon dhe publikon të dhënat e agreguara për transaksionet e lidhura të tregjeve nëpërmjet sportelit.

V. Dispozitat përfundimtare

Neni 29

Pjesa përbërëse e këtyre rregullave janë shtojca 1 dhe shtojca 2 me formularët përkatës.

Neni 30

Guvernatori i BPRMV-së përcakton “Standardin e qëllimit dhe formatin e porosive në Sistemin e kryqëzimit”.

Neni 31

Realizimin e këtyre rregullave e ndjek BPRMV-ja.

BPRMV-ja konsultohet dhe bashkëpunon me pjesëmarrësit e tregut, për avancimin e tregjeve nëpërmjet sportelit.

Gjatë tregtimit të tregjeve nëpërmjet sportelit, pjesëmarrësit e tregut sillen në mënyre etike dhe profesionale.

Neni 32

Me hyrjen në fuqi të këtyre rregullave, pushojnë së vlejture “Rregullat e mënyrës dhe procedurës së tregtimit dhe sheshimit të transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit” (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 81/11).

Neni 33


Këto rregulla hyjnë në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

O/V nr. 02-15/XIX-1/2021
3 dhjetor 2021
Shkup

Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së
Veriut,
д-р **Анита Ангеловска-Бежоска**

Shtojca 1

Skema e sheshimit të transaksioneve të letrave me vlerë të tregjeve nëpërmjet sportelit



Shtojca 2. Formularët

Drejtuar
Banka:
Adresa:
Tel., faksi:

Numri:
Data:
Vendi:

UDHËZIMET

e sheshimit të transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit, të dorëzuara nga shitësi (blerësi) deri te banka



SHITËSI



BLERËSI

Titulli (i personit juridik), emri dhe mbiemri (i personit fizik): _____

Numri amë (NVAQ) _____

Adresa: _____

Selia (e personit juridik), vendbanimi (i personit fizik): _____

Shteti: _____

Tel., faksi: _____

Data e lidhjes së transaksionit: _____

Data dhe koha e sheshimit të transaksionit: _____

Lloji i transaksionit: _____

ISIN-i i letrave me vlerë: _____

Shuma nominale: _____

Numri i letrave me vlerë: _____

Çmimi: _____

Te transaksionet definitive të letrave me vlerë të kuponit plotësohet:

Çmimi i pastër: _____

Çmimi bruto: _____

Shuma e të hollave:

Te transaksionet definitive të letrave me vlerë të kuponit plotësohet:

Shuma e pastër e të hollave _____

Shuma bruto e të hollave _____

Llogaria e letrave me vlerë të shitësit në DQLV: _____

Llogaria e letrave me vlerë të blerësit në DQLV: _____

Banka nëpërmjet së cilës pala kontraktuese sheshton: _____

Llogaria bankare e shitësit për transferimin e të hollave të letrave me vlerë të shitura (plotëson vetëm shitësi): _____

Llogaria bankare e blerësit për transferimin e të hollave të letrave me vlerë të blera (plotëson vetëm blerësi): _____

Llogaria bankare e blerësit për pagesën e letrave me vlerë të _____

Nënshkrimi

Drejtuar
Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë
Shkup

Data:

UDHËZIMET

e zëvendësimit të letrave me vlerë në bazë të transaksioneve repo të lidhure në
tregjet nëpërmjet sportelit

Data e lidhjes së transaksionit repo _____

Data e blerjes:

Data e riblerjes:

Përfundimi nr.

Data e zëvendësimit të letrave me vlerë: _____

Llogaria e letrave me vlerë të blerësit në DQLV: _____

Llogaria e letrave me vlerë të shitësit në DQLV: _____

Transferimet e llogarisë së letrave me vlerë të blerësit të llogarisë së letrave
me vlerë të shitësit në DQLV:

ISIN-i i letrave me vlerë: _____

Shuma nominale: _____

Numri i letrave me vlerë: _____

Transferimet e llogarisë së letrave me vlerë të shitësit të llogarisë së letrave me
vlerë të blerësit në DQLV:

ISIN-i i letrave me vlerë _____

Shuma nominale _____

Numri i letrave me vlerë: _____

Blerësi

Shitësi

Raporti i transaksioneve të letrave me vlerë në tregjet nëpërmjet sportelit të realizuara

Transaksionet definitive të realizuara dhe transaksionet repo me personat juridik:

Numri rendor	Përshkrimi	Lloji
1	Numri i amzës i bankës	an(7)
2	Numri i amzës i blerësit	an(7)
3	Numri i amzës i shitësit	an(7)
4	Lloji i transaksionit (D – definitive, R – repo)	an(1)
5	Data dhe koha e lidhjes	d (dd.mm.vvvv oo:mm:ss)
6	Data e sheshimit	d (dd.mm.vvvv)
7	ISIN-i	an(15)
8	Shuma nominale e letrave me vlerë	n
9	Çmimi*	n
10	Norma e interesit repo	n
11	Afati	n

Dy fushat e fundit plotësohen vetëm për transaksionet repo.

Nëse blerësi dhe/ose shitësi është person juridik-jorezident, tabela paraprase plotësohet me të dhënat vijuese:

Nr. rendor	Përshkrimi	Lloji
12	emri i personit juridik jorezident	an(100)
13	shtetësia e jorezidentit	an(2)
14	adresa e jorezidentit	an(30)
15	selia e jorezidentit	an(20)
16	shteti i jorezidentit	an(2)

Transaksionet definitive të kryera me personat fizik:

Numri rendor	Përshkrimi	Lloji
1	Numri i amzës i bankës	an(7)
2	Data dhe koha e lidhjes	d (dd.mm.vvvv oo:mm:ss)
3	ISIN-i	an(15)
4	Shuma nominale e përgjithshme e tregtuar e letrave me vlerë	n
5	Çmimi i ponderuar	n

an – të dhënat alfanumerike

d - të dhënat e datës/kohore

n - të dhënat numerike -

